



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2021:291626
Datë: 30.05.2024
Numri i dokumentit: 05758616

C.nr.2857/21

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, gjyqtari Shyqri Hoxha, me zyrtaren ligjore Sh.M. në çështjen juridike kontestimore të paditësve S.S. me numër personal E.E. me numër personal E.V. me numër personal N.G. me numër personal që të gjithë nga Prizreni, të cilët me autorizim i përfaqëson avokat B.Sh. nga Prizreni, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit- Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt të kontestit kompensimi i të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit, vlera e kontestit 1000.00 euro, jashtë seancës, më datë **30 maj 2024**, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET në tërësi e bazuar kërkesëpadia e paditësve S.S., E.V., N.G. që të gjithë nga Prizreni, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit- Drejtoria Komunale e Arsimit, për shkak të kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit.

II. DETYROHET e paditura, që paditësve, në emër të kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit, t'ua kompensoj shumat dhe atë:

- Paditësën S.S. për periudhën kohore prej datës 01.01.2019 deri më datë 30.04.2021 apo për 28 muaj (për çdo muaj shumën prej 55.35 euro, në shkallë prej 27 % të pagës bazë - 421 euro, në emër të diferencës së papaguar të kualifikimit), t'ia paguajë shumën prej **1549.8 euro**.
- Paditësin E.V. për periudhën kohore prej datës 01.01.2019 deri më datë 30.04.2021 apo për 28 muaj (për çdo muaj shumën prej 55.35 euro, në shkallë prej 27 % të pagës bazë - 421 euro, në emër të diferencës së papaguar të kualifikimit), t'ia paguajë shumën prej **1549.8 euro**.
- Paditësin N.G. për periudhën kohore prej datës 01.01.2019 deri më datë 30.04.2021 apo për 28 muaj (për çdo muaj shumën prej 55.35 euro, në shkallë prej 27 % të pagës bazë - 421 euro, në emër të diferencës së papaguar të kualifikimit), t'ia paguajë shumën prej **1549.8 euro**.

III. APROVOHET pjesërisht si bazuar kërkesëpadia e paditëses E.E. nga Prizreni, ashtu që **Detyrohet** e paditura, që paditëses, në emër të kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit, që për periudhën kohore prej datës 01.06.2019 deri me datë 30.05.2019, apo për 5 muaj (për çdo muaj shumë prej 55.35 euro, në shkallë prej 27 % të pagës bazë - 421 euro, në emër të diferencës së papaguar të kualifikimit), të ia paguaj shumë prej 276,75 euro, si dhe për periudhën kohore prej datës 01.06.2019 deri me datë 30.04.2021, apo për 23 muaj (për çdo muaj shumë prej 89.03, në shkallë prej 35 % të pagës bazë - 421 euro, në emër të diferencës së papaguar të kualifikimit), të ia paguaj shumë prej 2047.69 euro, e në shumë të përgjithshme prej 2324.44 euro.

Refuzohet pjesërisht si e pabazuar pjesa tjetër e kërkesëpadiës së paditëses E.E. përtej shumës së gjykuar sikur në pikën III. të dispozitivit të aktgjykimit deri në shumë e kërkuar prej 2492.84 euro, përkatësisht shuma prej 168.4 euro, në emër të kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit.

IV. DETYROHET e paditura, që paditësve, t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej **280.00 euro**, në afat prej 7 ditësh pas plotëfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësit S.Sh., E.E.,E.V., N.G. që të gjithë nga Prizreni, të cilët me autorizim i përfaqëson avokat B.Sh. nga Prizreni, pranë kësaj gjykate me datë 24.12.2021 kanë parashtruar padi, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit, Drejtoria Komunale e Arsimit, Prizren, me objekt të kontestit kompensimi i të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit, vlera e kontestit 1000,00 euro.

Në padi, i autorizuari i paditësve ka theksuar se paditësit janë të punësuar si mësimdhënës pranë ShFMU "Grncare", në fshatin Novosellë, komuna e Prizrenit, ku vazhdojnë të punojnë në këtë institucion. Tutje, ka theksuar se në bazë të Kontratës Kolektive të vitit 2017 paditësit i kanë plotësuar kushtet që në bazë të nenit 7 të kësaj kontrate, punëdhënësi Drejtoria Komunale e Arsimit në Prizren të ua bëjë kompensimin në bazë të kualifikimeve dhe licencimeve, ashtu që paditësve B.A., E.K., J.E., K.K., N.Ç. dhe N.M. u takon kompensimi mbi bazën e kualifikimit dhe licencimit Gjithashtu ka shtuar se paditësit kanë parashtruar kërkesë edhe në Drejtorinë Komunale të Arsimit në Prizren, mirëpo e njëjta e ka refuzuar kërkesën, pa asnjë arsye. Andaj, i kanë propozuar gjykatës që të aprovohet e bazuar kërkesëpadia e paditësve, në emër të kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit. Shpenzimet e procedurës i kanë kërkuar.

Me parashtresën e datës 05.12.2023, e të dorëzuar në gjykatë me datë 06.12.2023, i autorizuari i paditësve ka bërë precizimin e kërkesëpadiës, ashtu që ka kërkuar nga gjykata që të detyroj të paditurën Komuna e Prizrenit - DKA që paditësve S.Sh., E.V.,N.G. për periudhën prej datës 01.01.2019 e deri më 30.04.2021, në emër të kompensimit mbi bazën e kualifikimit në lartësi prej 27% të pagës bazë të iu paguaj diferencën e mbetur secilit shumë prej 55.35 euro për 28 muaj që arrin lartësinë për

secilin nga 1549.80 euro, si dhe për paditësen E.E. për periudhën prej datës 01.01.2019 e deri më 30.04.2021, në emër të kompensimit mbi bazën e kualifikimit në lartësi prej 35% të pagës bazë të iu paguaj diferencën e mbetur shumë prej 89.03 euro për 28 muaj, e që e arrin lartësinë 2492.84 euro. Po ashtu me këtë parashtrësë ka precizuar edhe shpenzimet e kërkuara procedurale dhe atë për taksë gjyqësore shumë prej 20 euro dhe për përpilimin e padisë shumë prej 260 euro.

E paditura, në përgjigjen në padi e ka kontestuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësve si të pa bazuar, duke kërkuar që gjykata të njëjtën ta refuzoj si të pabazuar. Ka theksuar se pretendimi i paditësve se i takon kompensimi për licencim është në kundërshtim me nenin 2 par. 1.1 të Kontratës Kolektive të Arsimit, sepse në atë dispozitë shkruan se përfitues të të gjitha beneficioneve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit janë vetëm për anëtarët e Sindikatës së Arsimit – SBASHK-ut, ndërsa paditësit nuk ka paraqitur fakte se është anëtar i kësaj sindikate, nuk ka dëshmuar me anë të kartelës së anëtarësisë. Po ashtu ka theksuar se paditësit ka ushtruar padi në gjykatë për realizimin e të drejtave pa përfunduar procedura administrative, sepse nuk i ka vazhduar procedurat në Inspektoratin e Punës në Prizren, që do të thotë se paditësit nuk i ka shterur të gjitha mjetet juridike në procedurën administrative, ashtu që i janë drejtuar gjykatës në kundërshtim me nenin 124 par. 6.1. të Ligjit për Procedurën Administrative, dhe me këto veprime të paditurës i shkaktojnë shpenzime të mëdha, sepse obligohen të paguajnë edhe shpenzimet e procedurës gjyqësore. Sa i përket obligimit lidhur me përmbushjen e detyrimit, e paditura në përgjigjen në padi thekson se vet Komuna e Prizrenit nuk është nënshkruese e Kontratës Kolektive, përkatësisht Qeveria e Republikës së Kosovës është garantues i implementimeve të KKAK-së, andaj Komuna e Prizrenit nuk ka kod buxhetor për përmbushjen e obligimeve që burojnë nga KKAK-ja. E paditura ka kontestuar kërkesëpadinë duke u bazuar në nenin 87 të Ligjit të Punës, duke deklaruar se paditësit ka humbur të drejtën për realizimin e kërkesës, pasi që ka kaluar afati 3 vjeçar, ashtu që ka arritur parashkrimi i kërkesës së paditësve. Me të gjitha të cekurat si më lartë, e paditura ka kërkuar që kërkesëpadia e paditësve të refuzohet në tërësi si e pabazuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 398 dhe 399 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadia e paditësve është pjesërisht e bazuar, andaj pa shqyrtim të çështjes, e aprovoi pjesërisht kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Ndërmjet palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se paditësit S.Sh. e lindur D., E.E.,E.V., N.G. që të gjithë nga Prizreni pune tek e paditura, si mësimdhënës pranë ShFMU “Grncare”, në fshatin Novosellë, komuna e Prizrenit. Mirëpo, kontestuese ishte nëse paditësve u takon e drejta e kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, përkatësisht diferencës konkrete të papaguar, si dhe nëse kërkesa e paditësve për kompensimin e të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit është parashkruar.

Në këtë drejtim, gjykata përmes diplomës me numër 45 të datës 04 dhjetor 2008 e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Edukimit, vërtetoi faktin se paditësja

S.D. ka kualifikim universitar dhe ka marrë titullin bachelor i programit fillor, ndërsa me licencën nr.100011959 i njëjti me datë 01.03.2013 është licencuar si mësimdhënëse.

Gjykata përmes diplomës me numër 3907 të datës 14 shtator 2017 e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti-Dega e Letërsisë Shqipe, vërtetoi faktin se paditësja E.E. diplomuar dhe ka marrë titullin bachelor i letërsisë shqipe, ndërsa me anë të diplomës me numër 785 të datës 06 qershor 2019 nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti-Dega e Letërsisë Shqipe, vërtetoi faktin se paditësja E.E. ka kualifikim universitar dhe ka marrë titullin Master i Shkencave Filologjike, ndërsa me licencën nr.10300014, e njëjta me datë 22.06.2021 është licencuar si mësimdhënëse.

Nga diploma me numër 65 të datës 11 mars 2010 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Edukimit - Prishtinë, gjykata vërtetoi faktin se paditësi E.V. Jeta ka kualifikim universitar dhe ka marrë titullin bachelor i mësimit klasor, ndërsa me licencën nr.100010939, i njëjti me datë 01.03.2013 është licencuar si mësimdhënëse.

Nga diploma me numër 227 të datës 23 mars 2015 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Edukimit - Qendra në Gjilan, gjykata vërtetoi faktin se paditësi N.G. ka kualifikim universitar dhe ka marrë titullin bachelor i programit Biologji-Kimi, ndërsa me licencën nr.100010229, i njëjti me datë 01.03.2013 është licencuar si mësimdhënëse.

Në vazhdim, bazuar në listën e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës, vërtetohet se lartësia e pagës bazë të paditësve S.Sh., E.E., E.V., N.G. është në shumë prej 421.00 euro, dhe se paditësve në emër të kualifikimit me diplomë universitare, në pagën bazë mujore iu është paguar shuma prej 58.32 euro.

Provat e lartcekura, gjykata i pranoi si provë materiale vendimtare, në kuptim të nenit 329 par. 1 të LPK-së, sipas së cilës dispozitë ligjore përcaktohet se “shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”. Andaj meqë këto dokumente janë të pranueshme edhe për vetë palën e paditur, pasi që të njëjtat nuk janë kontestuar, gjykata ia fali besimin e plotë.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë zbatohen dispozitat e Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33 të datës 29.08.2008. Kështu, në pikën 1. të këtij vendimi, përcaktohet që “nga 1 shtatori 2008 të gjithë mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional në shkollat e Republikës së Kosovës, do të kenë rritje të pagave të tyre në bazë të kriterëve të licencimit”. Ndërsa, në pikën 4. të vendimit në fjalë parashihet ngritja e pagës sipas shkallës apo nivelit të kualifikimit ose licencimit, në të cilën përcaktohet se “mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional, të pajisur: 1). Me diplomë të Shkollës Normale përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 10%; 2). Me diplomë të Shkollës së Lartë Pedagogjike përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 19%; 3). Me diplomë universitare 3 dhe 4 vjet përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 27% dhe 4). Me diplomë të ciklit të dytë dhe të tretë (Magjistraturë dhe Doktoraturë) përfitojnë ngritje të pagës

bazë prej 35%". Pastaj, bazuar në mendimin juridik të Gjykatës Supreme nr. 214/2023 të datës 09.10.2023, në pikën I. të tij përcaktohet që "për kërkesat e mësimdhënësve për kompensim mbi bazën e kualifikimit (licencimit), kompensimi bëhet sipas kushteve dhe kritereve të përcaktuara me Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33, datë 29.08.2008", vendim i cili ka qenë në fuqi deri më 06.02.2023.

Në rastin konkret, gjykata gjeti se e paditura ka për detyrim, që paditësve t'ia paguaj kompensimin mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, konform detyrimeve që rrjedhin nga Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33, datë 29.08.2008, sipas shkallës apo nivelit të kualifikimit ose licencimit të përcaktuar në këtë vendim. Më konkretisht, nga lista e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës dhe kontratat e punës, rezulton se e paditura, në emër të kualifikimit apo licencimit në pagën bazë, iu ka paguar paditësve S.Sh., E.V., N.G. prej 58.32 euro. Sipas pikës 4 nën pikës 3 të Vendimit nr.01/33 të datës 29.08.2008, paditësit përfitojnë ngritje prej 27% të pagës bazë, që në rastin konkret paditësit S.Sh., E.E.,E.V., N.G. përfitojnë ngritje në pagën bazë, në emër të licencimit apo kualifikimit shumë prej 113.67 euro. Andaj, gjykata vendosi si në pikën nën I. të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke e detyruar të paditurën që paditësve S.Sh., E.E.,E.V., N.G. për çdo muaj t'iu paguaj shumë prej 55.35 euro apo diferencën e mbetur për 28 muaj nga data 01.01.2019 e deri më datë 30.04.2021, secilit paditës në shumë të përgjithshme prej **1549.8 euro** ($28 \times 55.35 = 1549.8$).

Ndërsa sa i përket vendosjes si në dispozitivin nën III të këtij aktgjykimi, më saktësisht lidhur me aprovimin pjesërisht të kërkesëpadisë së paditëses E.E. gjykata deri tek kjo vendosje erdh duke analizuar kërkesën e palës paditëse në raport me provat e adminstruara, ngase pala paditëse ka kërkuar që të i paguhet diferenca e papaguar në bazë të kualifikimit që e njëjta e ka në bazë të ngritjes profesionale Master i Shkencave Filologjike dhe atë në shkallën prej 35%, të pagës bazë. Nga prova e adminstruar, më saktësisht Diploma me nr, 785 e datës 06 qershor 2019, gjykata vërtetoi faktin se nga kjo datë pala paditëse ka fitur titullin Master i Shkencave Filologjike, andaj nga data në fjalë të njëjtës i ka takuar rritja në pagën bazë në lartësi prej 35%, por që paditëses nga ana e palës së paditur i është paguar vetëm shuma prej 58.32 euro. Duke marrë parasysh se paga bazë e paditëses është në lartësi prej 421 euro e duke e llogaritur prëqindjen prej 35% të kësaj page bazë, të njëjtës për periudhën kohore prej muajit qershor 2019 deri me 30.04.2021, për secilin muaj i kanë takuar rritje në pagë shuma prej 147,35 euro. Andaj nga kjo rrethanë gjykata gjeti se palës paditëse për këtë periudhë kohore duhet të i paguhet nga ana e palës së paditur diferenca e papaguar në lartësi prej 89.03 euro, më saktësisht për 23 muaj e që arrin lartësinë prej 2047,69 euro ($23 \times 89.03 = 2047.69$). Po ashtu gjykata gjeti se palës paditëse E.E. për periudhën kohore prej muajit janar deri në muajin maj të vitit 2019, i takon pagesa e rritjes në pagë në bazë në lartësi të 27%, pasi që e njëjta në këtë periudhë kohore ka pasur nivelin e studime Bachelor, andaj për këtë periudhë kohore për secilin muaj të njëjtës i takon diferenca e mbetur e papaguar në lartësi prej 55.35 euro, e në shumë prej 276.75 euro ($5 \times 55.35 = 276.75$). Andaj nga të lartëcekurat e paditura detyrohet që paditëses në emër të rritjes së pagës bazë sipas shkallës apo nivelit të kualifikimit ose licencimit, të ia paguaj diferencën e papaguar në shumë e përgjithshme prej 2324.44 euro.

Gjykata vendosi si në dispozitivin nën IV, të këtij aktgjykimi duke ia refuzuar pjesërisht kërkesëpadinë e palës paditëse E.E. ngase e njëjta edhe për periudhën kohore prej muajit janar deri në muajin maj 2019, për të cilën periudhë sipas provave të lartëcekura, e njëjta nivelin e studimeve e ka pasur Bachelor dhe se për këtë periudhë i ka takuar shtesa në pagën bazë sipas shkallës apo nivelit të kualifikimit ose licencimit në lartësinë prej 27%,e jo 35% siç e ka kërkuar pala paditëse. Andaj për këtë periudhë kohore gjykata me anë dispozitivit nën III të këtij aktgjykimi i ka njohur palës paditëse vetëm diferencën e papaguar në shumën prej 55.35 euro për secilin muaj, ndërsa e ka refuzuar kërkesëpadinë mbi këtë shumë më saktësisht e ka refuzuar shumën prej 33.68 euro për secilin muaj e në shumë të përgjithshme prej 168.4 euro ($5 \times 33.68 = 168.4$).

Gjykata me rastin e vendosjes jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në nenin 398 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton se "kur gjykata, pasi t'i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritore, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë". Po ashtu, gjykata vendosi jashtë seancës gjyqësore edhe në kuptim të nenit 399 par. 1 të LPK-së, pasi që pjesa tjetër e kërkesëpadsisë së paditëses është e pabazuar në dispozita ligjore. Në këtë drejtim, sipas nenit 399 par. 1 të LPK-së parashihet që "kur gjykata, pasi t'i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadsisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritore me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadsia".

Lidhur me kundërshtimet tjera të palës së paditur dhënë në përgjigje në padi, gjykata vlerësoi se të njëjtat nuk janë të bazuara në dispozita ligjore dhe nuk kanë mbështetje në ndonjë bazë faktike apo juridike. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit meritore.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë konform nenit 449 dhe 453 të LPK-së lidhur me nenin 463 par. 1 të LPK-së, duke obliguar të paditurën që në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore, paditësve t'ua paguajë shumën e përgjithshme prej 332.00 euro, sipas Tarifës së Odës së Avokatëve, për përpilimin e padsisë shumën prej 312 euro dhe për taksë gjyqësore shumën prej 20 euro.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me nenin 398 e 399 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil
C.nr.2857/2021, më datë 30 maj 2024

Gjyqtari

Shyqri Hoxha

Numri i lëndës: 2021:291626
Datë: 30.05.2024
Numri i dokumentit: 05758616

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimi të të njëjtit, pranë Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për gjykatën dhe për palët.